



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1595/12 prot

Datë 26.06.2026

V E N D I M
Nr. 880/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 821/2026, datë 17.06.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, “ me nr. REF-81507-04-09-2026, me objekt: “Loti 2: Benzine”, me fond limit 1,790,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Korce.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Olsi” SHPK me NUIS J63423463I dhe adresë: Nr. Pasurie 68/3, Zona Kadastrale Nr.2890 , Griz, Fier
- Autoriteti Kontraktor:** Ndermarrja e Sherbimeve Publike Korce, me adresë: Rr. “28 Nëntori”, nr.1, Lgj.7, Korçë, Kodi Postar 7001
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 17.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.821/2026, ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Olsi” SHPK lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-81507-04-09-2026, me objekt: “Loti 2: Benzine”, me fond limit 1,790,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Korce.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Europetrol Durres Albania” SHA dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar atë.*
3. *Autoriteti kontraktor të bëjë rivlerësim të procedurës së prokurimit në SPE, në zbatim të konstatimeve të KPP-së në këtë vendim.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera*
5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Olsi” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.949/1 prot., datë 22.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1595/8 prot., datë 24.06.2026, autoriteti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Korce informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 821/2026, datë 17.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.949/1 prot., datë 22.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1595/8 prot., datë 24.06.2026, autoriteti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Korce informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 821/2026, datë 17.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 821/2026, datë 17.06.2026 të KPP-së. Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 821/2026, datë 17.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me arsyetimet e konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-81507-04-09-2026, me objekt: “Loti 2: Benzine”, me fond limit 1,790,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Korce.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

